



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M


Nr. 10, datë 15.04.2021

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“PARK VIEW RESIDENCE”,
ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “LIMAN KABA”, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesve, shoqërisë “IR” sh.p.k dhe personave fizikë Rajmonda Agalliu dhe Jonuz Ismailaj, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Park View Residence”, me vendndodhje në rrugën “Liman Kaba”, Bashkia Tiranë”, me zhvillues shoqërinë “IR” sh.p.k dhe personat fizikë Rajmonda Agalliu dhe Jonuz Ismailaj, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 08.11.2019, të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.7, datë 08.11.2019, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

